



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2025

Datë. 21.05.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim Ndër Komunal, dhe në nenin 6 të Rregullores nr.0203-1334 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar të datës 18.12.2012, në mbledhjen e mbajtur me datë.21.05.2025, pas diskutimeve lidhur më pikën e 3-të të rendit të ditës: Propozim vendim për miratimin e Nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Ferrara të Republikës së Italisë, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Ferrara të Republikës së Italisë.
2. Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Ferrara, të Republikës së Italisë, do të bëhet në fushën e Kulturës, Turizmit, Mjedisit dhe të tjera.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Ferrara, të Republikës së Italisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të Komunës.

5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	19.05.2025 01-413/k-25444
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim-Vendim për bashkëpunim Komunal ndërkombëtar me qytetin e Ferrarës, Itali

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 12 shkronja (d), nenit 40 shkronja (j) si dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër-Komunal, si dhe nenit 6 të Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, Kryetari i Komunës i parashtroi Kuvendit të Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në bashkëpunim Ndër-Komunal.
2. Bashkëpunimi Ndër-Komunal do të zhvillohet me Komunën e Ferrarës, Itali.
3. Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryetari i Komunës dhe administrata e Komunës së Gjakovës.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në pajtim me nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në mbështetje të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores Nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, si dhe nenit 5 të Rregullores Për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, me datë: 19.05.2025, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimin e:

**NISMËN
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E
FERRARËS - ITALI**

NË FUSHËN E KULTURËS, TURIZMIT, MJEDISIT DHE TË TJERA

1. Bashkëpunimi Ndërkomunal do të zhvillohet me komunën e **Ferrarës, Itali**.
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e kulturës, turizmit, mjedisit dhe të tjera, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat përkatëse. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumë anshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim-vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës;
4. **Arsyetimi**– Nisma për bashkëpunimin Ndërkomunal me Komunën e Ferrarës nga Republika e Italisë, bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy Komunave në fushat e lartë cekura. Duke u nisur nga potenciali për bashkëpunim socio-ekonomike dhe kulturore të të dy qyteteve, formalizmi i këtij bashkëpunimi përmes binjakëzimit të qytetit të Gjakovës dhe Ferrarës është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës